



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:286149

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05583421

Ac.nr.118/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci - kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.H., nga Obiliqi, e përfaqësuar nga përfaqësi ligjor S.H., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokatura M.B.N sh.p.k., me seli Prishtinë, përkatësisht B.S. dhe N.S., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K.S. “K.R.”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.B., për kompensimin e dëmit nga shkaktimi i aksidentit, duke vendosur lidhur me ankesat e të autorizuarit të palës paditëse dhe palës së paditur të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1045/15, të datës 09.07.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa paditëses M.H., nga Obiliqi, si dhe pjesërisht ankesa e të paditurës K.S. “K.R.”, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1045/15, i datës 09.07.2020, në pikën I a) të dispozitivit sa i përket shumave për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, si dhe në pikën II të dispozitivit në pjesën ku është cekur shuma e përgjithshme dhe koha e fillimit të rrjedhjes së kamatës, dhe gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura K.S. “K.R.”, me seli në Prishtinë, që paditëses M.H., nga Obiliqi, në emër të kompensimit të dëmit jo material për dhimbje fizike, t’ia paguaj shumën prej 2,000.00 euro, dhe për frikën e përjetuar t’ia paguaj shumën prej 1,500.00 euro, ndërsa mbi shumat e gjykuara refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses e pabazuar. **DETYROHET** e paditura, që paditëses, shumën e përgjithshme prej 6,609.00 euro (në emër të dëmit jo material dhe material) t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, dhe atë për dëmin jo material duke llogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 09.07.2020, e deri në pagesën definitive, ndërsa për dëmin material duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 04.05.2015, deri në pagesën definitive.

II. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e paditëses M.H., nga Obiliqi, si dhe pjesërisht ankesa e të paditurës K.S. “K.R.”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1045/15, i datës 09.07.2020, në pikën I a) dhe b) të dispozitivit, ku është vendosur për kompensimin e dëmit jo material në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor prej 5%, dhe dëmit material për shpenzimet e mjekimit, për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj, për ushqim të përforcuar, në pikën II sa i përket lartësisë së kamatës dhe afatit të përmbushjes së detyrimit, si dhe në pikën III dhe IV të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1045/15, të datës 09.07.2020, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.H. nga Kastrioti (Obiliqi), ashtu që DETYROHET e paditura K.S. “K.R.” me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 16.03.2015, t’ia paguaj paditëses shumat si vijon: a) Në emër të dëmit jo-material: Për dhimbje fizike-trupore, shumën 850.00 €; Për frikën e përjetuar, shumën 680.00 €; Për zvogëlimin e aktivitetit jetësor prej 5%, shumën 2500.00 €. b) Në emër të dëmit material: Për shpenzimet e mjekimit, shumën 9.00 €; Për ndihmën e dhënë dhe përkujdesin e huaj për dy muaj, shumën 300.00 €; Për ushqimin e përforcuar për dy muaj, shumën 300.00 €.

II. DETYROHET e paditura K.S. “K.R.” me seli në Prishtinë, të paguaj shumat e gjykuara për paditësin si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme 4639.00 €, me kamatën ligjore 8%, e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë (04.05.2015) deri në datën e pagesës definitive, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes / plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitivit.

IV. DETYROHET e paditura K.S. “K.R.” që në afatin kohor prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, në shumën prej 778.40 €”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë:

I autorizuari i paditëses për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sa i përket lartësisë së kompensimit, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoi ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj në kuptim të lartësisë së kompensimit.

I autorizuari i të paditurës për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoi ankesën e të paditurës si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe lënda t’i kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës

së shkallës së parë ose aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe të gjykohet në shumat e ofruar nga e paditura.

Përgjigje në ankesa nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses dhe ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 04.05.2015, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit. Në padi ka parashtruar së me datë 16.03.2015, rreth orës 14:00, në rrugën "...", në Prishtinë, është shkaktuar aksident komunikacioni, dhe deri të aksidenti ka ardhur me fajin e ngasësit të automjetit "A", i cili për shkak të pakujdesisë e ka goditur paditësen e cila në atë rast ishte në cilësi të këmbësorës duke e kaluar rrugën në vija të bardha, të cilës i ka shkaktuar lëndime trupore. Ka theksuar së shkaktari i aksidentit ka poseduar policë të sigurimit tek e paditura. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, përmes parashtrësës së datës 06.03.2020, e ka precizuar lartësinë e kërkesëpadisë, ashtu që ka kërkuar që të miratohet kërkesëpadija e paditëses dhe të obligohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material të pësuar në aksidentin e datës 16.03.2015, t'ia paguaj shumat si në vijim: për dhimbje fizike shumë prej 5,000.00 €, për frikë shumë prej 4,000.00 €, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor të shprehur në shkallë prej 5%, shumë 11,000.00 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 300.00 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 300.00 €, për rehabilitim fizioterapeutik shumë prej 300.00 €, për shpenzimet e mjekimit shumë prej 9.00 €, gjithsej shumë prej 19,209.00 €, me kamatë në lartësi prej 8% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,216.80 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar. E paditura gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket lartësisë së saj duke i ofruar shumë prej 2,500.00 euro, dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses mbi këtë shumë ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar të paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.1045/15, të datës 09.07.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara, ka konstatuar së në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditëses i takon e drejta në kompensim nga e paditura mirëpo kontestuese ishte lartësia e kërkesës për kompensim

nga aksidenti i shkaktuar në datën 16.03.2015. Nga raporti i aksidentit ..., i datës 16.03.2015, gjykata ka konstatuar së aksidenti është shkaktuar nga automjeti i tipit veturë "...", i cili ka mbajtur licencë sigurimi nga e paditura K.R., kur ngasësi i saj nga pakujdesia e ka goditur paditësen me veturë e cila po kalonte rrugën në vendkalimin për këmbësorët, para udhëkryqit në rrugën ... dhe ... në Prishtinë. Gjykata tutje përmes Raportit të QKUK — Qendra Emergjente nr. 8823, të datës 16.03.2015, ka konstatuar së paditësja ishte dërguar pranë kësaj qendre për trajtim të menjëhershëm nga aksidenti, nga i cili kishte pësuar lëndime në këmbë dhe është trajtuar me mobilizim të këmbës me gips, sipas ekzaminimit dhe rekomandimeve për trajtim nga mjeku L.R.K.. Gjykata në cilësi të provave materiale ka administruar ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr.N.D.-specialist i ortopedisë, dhe B.O.-specialist i psikiatrisë, të datës 05.03.2020, nga e cila ka konstatuar së paditësja-e dëmtuara nga aksidenti i trafikut rrugor, është diagnostifikuar me “Epiphisiolysis pars distalis tibie dex.” apo Epifiziolizë — rrëshqitje dhe thyetje e zonave të rritjes, në pjesën e poshtme të kockës së kërcirit të djathtë dhe është trajtuar me imobilizim me gips. Ekspertet kanë konstatuar se si pasojë e aksidentit në fjalë, paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore, i cili manifestohet me zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm mjekësor prej 5%, dhe ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që ka zgjatur 20 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë që ka zgjatur 24 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për 21 ditë, dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat kanë mbetur prezent sidomos gjatë sforcimeve fizike, ndërrimit të motit apo gjatë ecjeve të gjata. Me tutje ka konstatuar së paditësja ka përjetuar frikë primare që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur rreth një orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur rreth tre muaj, si dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët që ende zgjatë, sidomos nga rikujtimi i momentit të aksidentit apo kalimi në vendin ku është shkaktuar ngjarja. Gjykata bazuar në këtë ekspertizë ka konstatuar së paditëses i është nevojitur ndihma nga personi i tretë në kohëzgjatje prej dy muajve, ushqimi i përforcuar për dy muaj. Bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses ashtu që për dëmin jo material për dhimbje fizike i ka gjykuar shumën prej 850.00 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 680.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 5% shumën prej 2,500.00 euro, në emër të dëmit material për shpenzimet e mjekimit, shumën 9.00 euro, për ndihmën e dhënë dhe përkuajdesin e huaj për dy muaj, shumën 300.00 euro, për ushqimin e përforcuar për dy muaj, shumën 300.00 euro. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë lidhur me kërkesën e palës paditëse përtej shumave të gjykuara, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit, me çka ka refuzuar kompensimin e dëmit material dhe jo material sepse nuk gjeti bazë ligjore e materiale për mbështetje të kërkesës së palës paditëse. Gjykata e ka refuzuar në tërësi kërkesën e palës për kompensimin e trajtimit në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik, sepse pala paditëse nuk prezantuar llogari valide të shpenzimeve të rehabilitimit as me shkresat e lëndës e as gjatë shqyrtimit gjyqësor. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata i është referuar nenit 179 të LMD-së, dhe dispozitave të Rregullores së BQK-së për caktimin e kriterëve dhe vlerësimin e dëmeve nga autopërgjegjësia. Për kamatën ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 par.2 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar lartësinë e kërkesëpadisë në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar dhe për kohën e fillimit të rrjedhës së kamatës për dëmin jo material, për çka u deshtë që aktgjykimi i atakuar në fjalë të ndryshohet dhe të vendoset si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi të gjykatës së shkallës së dytë.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së ekspertëve gjyqësor Dr.N.D.-specialist i ortopedisë, dhe B.O.-specialist i psikiatrisë, të datës 05.03.2020, i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykata e Apelit, nuk është lëshua në analizë më të zgjeruar sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë, pasi që nga e paditura nuk është kontestuar fakti së aksidenti në të cilin paditësi ka pësuar lëndime trupore është shkaktuar nga i siguruari i saj, por është kontestuar vetëm lartësia e kërkesëpadisë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo nga fakti se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga ekspertët nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë, përmes të cilëve pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses dhe dokumenteve mjekësore, në ekspertizën në formë të shkruar është vërtetuar natyra e lëndimit dhe pasojat për paditësen. Andaj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se në rastin konkret shumat e gjykuara nuk përkojnë me lëndimet e pësuarra dhe janë jashtë çdo praktike gjyqësore, për arsye se gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes ekspertizave mjekësore të ekspertëve mjekësor nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë për të cilat ekspertiza ka dhënë shpjegimet e saj në arsyetim të aktgjykimit, prandaj në këtë kontekst edhe Gjykata e Apelit i ka pranuar vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë.

Në anën tjetër, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditurës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket shumave të gjykuara ndërsa pretendimet e paditëses për zbatim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket shumave të gjykuara në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike dhe për frikën e përjetuar kanë rezultuar të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar dispozitën e nenit 179 të LMD-së, kur ka gjykuar forma të dëmit jo material për dhimbje fizike dhe frikën e përjetuar, pasi që shumat janë të ulëta dhe nuk u shkojnë përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Sipas nenit 136 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) është paraparë së *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Tutje neni 137 të LMD-së, përcakton se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*. Ndërsa në nenin 159 par. 1 i LMD-së, është paraparë së: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”*. Kurse me dispozitën e nenit 183 par.1 dhe 2 të LMD-së përcaktohet se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj dhe me qëllim shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara si dhe frikës së të dëmtuarës, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësja i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për atë që është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditëses, e ndryshoi aktgjykimin e atakuar në pikën I a) të dispozitivit, dhe gjykoj si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që ka gjetur se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material për dhimbje fizike dhe frikën e përjetuar nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, as në praktikën gjyqësore të krijuar për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar. Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e gjykuara si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 të LMD, kjo duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve intensitetin e dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar nga paditësja, moshën e paditëses e cila në kohën e shkakut të aksidentit ende nuk i kishte mbushur 7 vite, andaj këto shumat përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që e dëmtuara (në këtë rast paditësja) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para.

Duke qenë se Gjykata e Apelit, ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke i rritur shumat e kërkuara për dhimbje fizike dhe për frikën e përjetuar, gjykata në këtë rast e ka ndryshuar edhe pikën II të dispozitivit të aktgjykimin atakuar, pasi që në këtë pikë ishte cekur shumat e përgjithshme të cilën gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar në emër të dëmit material

dhe jo material, andaj Gjykata e Apelit, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ngase gjeti se shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë për bazën e dëmit jomaterial, përkatësisht për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 5%, janë adekuate me shkallën e të mirës së privuar të dëmtuarës, këtu paditëses, si pasojë e aksidentit të përjetuar dhe se këto shuma do të jenë një saktisfaksion moral që deri diku e njëjta t'i kompensoj ato të mira për aq sa kjo do të jetë e mundur. Në raport me këtë, gjykata e shkallës së dytë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditëses për kompensimin e dëmit jomaterial për zvogëlimin të aktivitetit jetësor sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Ndërsa, sa i përket shumës së kompensimit të dëmit material për ushqim të përforcuar, për ndihmë të huaj dhe për shpenzimet e mjekimit, e cila po ashtu është vërtetuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo duke marrë për bazë kohëzgjatjen nevojës për përkujdesjen e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar të konstatuar në ekspertizë mjekësore për paditësen si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njuh raste të tilla të kompensimit. Duhet të pasur parasysh fakti se për këto kategori të dëmit material në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshin ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo pasi që paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar të konstatuar në ekspertizë, të njëjtës i takon ky lloji dëmi i kërkuar në shumat e gjykuara. Ndërsa shuma e gjykuar për dëmin material në emër të shpenzimeve e mjekimit është vërtetuar në bazë të kuponit fiskal i cili është pjesë e shkresave të lëndës, ku edhe në bazë të ekspertizës mjekësore është konstatuar së fatura e prezantuar në shkresat e lëndës ka lidhje kauzale për shpenzimet e bëra gjatë shërimit.

Gjykata e Apelit, e aprovoj pjesërisht të bazuar ankesën e të paditurës sa i përket kohës së fillimit të rrjedhës së kamatës për dëmin jo material, pasi që gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale sepse kamatën si për dëmin material ashtu edhe për dëmin jo material e ka gjykuar në lartësi prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë datë 04.05.2015. Duke qenë së fakti së paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar dëm jo material është vërtetuar vetëm pas nxjerrjes së ekspertizës mjekësore dhe pasi që gjykata e shkallës së parë e ka bërë vlerësimin kësaj ekspertize, për këtë arsye Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 170 dhe 382 të LMD-së, ka vendosur që të ndryshohet pika II e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën ku është cekur koha e fillimit të rrjedhjes së kamatës, ashtu që e njëjta është gjykuar për dëmin jo material duke llogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 09.07.2020, e deri në pagesën definitive, ndërsa për dëmin material duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 04.05.2015, deri në pagesën definitive, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket lartësisë së kamatës së gjykuar në shkallë prej 8%, Gjykata e Apelit, vlerëson së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur për lartësinë e kamatës

bazuar në nenin 382 par.2 të LMD-së e cila dispozitë përcakton së “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”. Ky ligj ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të aksidentit dhe është i zbatueshëm për rastin konkret, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, është i pabazuar pretendimi i të paditurës së kamata për dëmin jo material është dashur të gjykohej në lartësi siç e paguajnë bankat vendore për mjetet e afatizuara një vjeçare pa destinim të caktuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është vlerësuar se është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, dhe në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit e neni 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.118/2021, datë 28.03.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci